

VENDIM
Nr. 489, datë 19.7.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË**

(Ndryshuar me VKM nr. 827, datë 18.12.2019)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a-së.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 884.37 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë tridhjetë e shtatë) m² tokë arë, me shumën e përgjithshme 384 412 (treqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), si subjekti kërkuar i këtij shpronësimi.

5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit korrik 2017.

6. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi, të dorëzojë pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin bankar, lidhur me numrin e llogarisë dhe IBAN-in, si dhe kopjen e kartës së identitetit, të shoqëruar me një kërkesë.

7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E
ENERGJISË DHE INDUSTRIË**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë arë

Nr.	Të dhëna për pronësinë							Sip. e shpronësimit për nënstacionin m ²	Vlera e shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m ²				
Bashkia Vlorë											
Tragjas											
1	Merushe		Harizaj	3621	998/23	Arë	2046	1723.2	204	351533.0	
2	Krenar		Harizaj	3621	998/24	Arë	2046	75.69	204	15441.0	Bashkëpronësi
Sipërfaqe totale për shpronësim në m ²								1798.89			
Shuma totale në lekë për shpronësim										366974	

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTT
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110 KV ORIKUM DHE NËNSTACIONIT 110 KV HIMARË”

Për disa shtesa në VKM-në nr. 489, datë 19.7.2017 “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110 kV Orikum dhe nënstacionit 110 kV Himarë”

(Shtuar me VKM nr. 827, datë 18.12.2019)

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr/pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale / Lekë	Shënime
					Tokë Arë / m ²	Tokë Arë / m ²		
1	Sherif Lushaj	3621	1000/6	1000	38.38	204	7,830	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Shadije Gjonzeneli	2832	28/18	10000	47.1	204	9,608	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale e shpronësimit					85.48		17,438	